

FJALA E DEPUTETIT FLAMUR NOKA

E ENJTE 16 SHTATOR 2021

Të nderuar kolegë,

Zonja dhe zotërinj,

Sot për të gjithë shqiptarët është një ditë e zyrtë. Sot për të gjithë shqiptarët është një ditë e vështirë, madje mund të themi nga më të vështirat e këtij tranzicioni të gjatë. Sot nuk kemi përballë një maxhorancë që përfaqëson vullnetin e shqiptarëve, por kemi përballë një maxhorancë që është tërësisht ilegjitime, një maxhorancë që është produkt i votave të blera, i pazareve të pista. Sot kemi përballë një maxhorancë që do të votojë një qeveri, e cila në 8 vjet nuk ka bërë asgjë tjetër, veçse në vend të qeverisjes, ka bërë shqeverisje, ka bërë vjedhje, krim dhe korrupsion, ka asgjësuar demokracinë. Sot kemi përballë një maxhorancë, e cila ka përdhunuar shenjtërinë e votës, ka pushkatuar votën e lirë dhe e ka nxjerrë atë në treg a thua se është mall. Sot kemi përballë, në këtë anë, deputetë që kanë dalë nga votat e krimit të organizuar; sot kemi përballë deputetë, në këtë anë, që janë produkt i parave të drogës; sot kemi deputetë, në këtë anë, që janë produkt i parave të korrupsionit të shfrenuar qeveritar.

Sot kemi një qeveri, e cila vetëm parimet e një demokracie nuk i ka respektuar për asnjë ditë në jetën e saj politike; sot kemi përballë një qeveri që ka abuzuar me fondet e shqiptarëve dhe taksat e tyre. Tërmeti ishte një nga fatkeqësitë që i ra këtij vendi dhe qytetarëve shqiptarë, por, për turp, Edi Rama dhe qeveria e tij e shfrytëzuan dhe e shndërruan atë nga fatkeqësi të shqiptarëve në fatmirësi të xhepave të tyre. E kemi parë të gjithë se çfarë ndodhi në fushatë. Paratë e tërmetit, legalizimet, vaksinat së bashku me paratë e drogës dhe të krimit të organizuar ishin buqeta që u ofronte qeveria shqiptarëve në shkëmbim të votës, a thua se po u bënte dhurata dhe nuk ishin detyrime të një shteti dhe pushteti! Sot kjo maxhorancë do të votojë qeverinë “Rama 3”, e cila nuk ka asnjë ndryshim nga “Rama 1” dhe “Rama 2”, por thjesht një makijazh femëror. A ishin Rama dhe rilindja ata që në 8 vjet qeverisën, kanabizuan Shqipërinë?! A ishin Rama dhe rilindja që në këta 8 vjet qeverisje e shndërruan Shqipërinë në aeroport, ku më shumë se sa avionët e qytetarëve dhe pasagjerëve, uleshin avionët e drogës?! A ishte Shqipëria e qeverisur nga Rama dhe rilindja në këta 8 vjet pika kyçe, kryqëzim i trafikut të të gjitha drogave të forta?! A ishte Shqipëria kryeqendra e krimit të organizuar, që importonte në të gjithë Europën? A ishte Shqipëria e qeverisur nga Rama një Shqipëri e zhytur në korrupsion si kurrë ndonjëherë? A ishte Rama Kryeministër, kur korrupsioni e kishte mbërthyer ekonominë dhe sot e ka zhytur në këtë pikë derexheje ku është? A ishte Rama Kryeministër në këta 8 vjet, kur shqiptarët varfëroheshin përditë dhe rriheshin nga qeveritarët? A ishte Rama Kryeministër, kur u larguan mbi 500 mijë shqiptarë nga ky vend? A ishte qeveria që drejtohej nga Rama, ajo që e rrënoi Shqipërinë dhe shoqërinë shqiptare në çdo aspekt?

Gjithkund pretendohet të zihet vendi i parë për mirë, por është vetëm qeveria e Ramës që në çdo klasifikim zinte vendin e parë për krim, korrupsion, trafik dhe drogë. Pra vetëm për keq. Kjo bëri që shqiptarët të mos kenë më shpresë dhe t'i kenë sytë drejt arratisë. Të gjitha këto mos vallë ndodhën rastësisht? Të gjitha këto ishin me vullnet të qartë politik në një vend demokratik. Nëse në një vend tjetër një qeveri do të bënte gjëma të tilla, 1, 2 dhe 3, do të ishte, do të ndëshkohej me votë. Pse nuk ndodh në Shqipëri një gjë e tillë, do të thoni ju? Sepse në Shqipëri Rama u kujdes, përveç të tjerash, të vrasë edhe demokracinë, të zhdukë rregullat e saj dhe ka ruajtur vetëm fasadën, si në çdo aspekt

tjetër të qeverisjes së tij të gjatë. A ka punuar Rama në mandatin e parë dhe të dytë për të qeverisur? Jo! Ka punuar çdo ditë për të instaluar një regjim, ku vetëm fasadën duhet ta kishte demokratike dhe përmbajtja duhet të ishte despotike. Kjo është ajo qeveri që u paraqitet shqiptarëve sot, një regjim ku liria e votës do të ishte një temë thjesht që të artikulohej, por që vota e lirë nuk duhej të ekzistonte. Tregu duhet të përcaktojë votën. Kjo nuk ndodh në asnjë demokraci, por vetëm nëpër regjime. Vota në një zonë të varfër kushtonte 100 euro, 200 euro në një zonë të mesme dhe 500 euro në një zonë më të kamur. E kuptoni çfarë ndodh, apo jo? Pra, kjo është qeveria që ne kemi sot, produkt i votës së blerë, i votës së censuruar dhe të devijuar. Kjo ndodhi këtë pranverë, masakër elektorale, sepse regjimet e urrejne votën e lirë dhe dalin si produkt i masakrave elektorale. E provova vetë në zonën time. Sigurisht, këtyre iu thyen hundët në zonën time, por sërish nuk lanë gjë pa përdorur në Kamzë dhe Paskuqan, a thua se kishte rënë bomba atomike, jo tërmeti. Bëheshin mijëra lista për familjet që duhet të përfitonin nga lekët e tërmetit. Pse? Për të blerë votën. U jam mirënjohës përjetë banorëve të Kamzës dhe Paskuqanit që rezistuan dhe triumfuan si kurrë ndonjëherë! Kjo zonja pas meje nuk la makinacion e shantazh pa përdorur ndaj çdo qytetari dhe hallexhiu. Njerëzve që nuk deklarorin votën pro rilindjes u hiqej ndihma ekonomike, u hiqej asistenca, kërcënoheshin me vendin e punës së tyre, të familjarëve apo miqve të tyre. 15 milionë deri në 30 milionë ka marrë një familje, gjoja dëmshpërblim për tërmetin në Bathore. Pse? Që t'i jepnin votën rilindjes. A është kjo qeverisje? Jo, është një regjim. Por çfarë meriton regjimi? Regjimi nuk meriton një opozitë me fjalime, por përballje çdo ditë, kudo, në rrugë, në rrugica, në sheshe, këtu në sallë. Përballja është zgjidhja derisa ta çrrënjosim. Regjimi nuk meriton debate, regjimi nuk meriton të ulesh bashkë me të, por kërkon vetëm një rrugë: përballje dhe rrëzim, me çdo mënyrë dhe mjet demokratik, sepse shqiptarët nuk e meritojnë, pasi nuk e kanë votuar këtë regjim. Ndaj, vetëm përballja do ta shpëtojë këtë vend. Vetëm rrëzimi dhe çrrënjosja e këtij regjimi do ta ndezë shpresën për një Shqipëri të lirë, demokratike dhe të begatë. Faleminderit!